



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

Industria Energjitike, I.D 1.7 Gaz natyror ose GNL, pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave.
I.D 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.



Subjekti: “LINDA 80” sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: SHKURTAN MADANI



Tirane, 2022



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « PerLejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administriminmjedisor tembetjeve tengurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajritngandotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruartembetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes seveprimtarive qendikojne nemjedis per tecilat kerkohetlejemjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largiminpublik tembeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organevemjedisore per tesiguruarpjesemarrjen e publikutdhe te OJF-vemjedisore neprocesin e vleresimit tendikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Permiratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipaveA,Bdhe C per transferimin e lejevenganjesubjekt te tjetri, tekushteve per lejetrespektive temejdisit si dherregullave tehollesishme per shqyrtimin e tyrengaautoritetekompetentederi neleshimin e ketyrelejevenga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

• Procesi i punes

Subjekti "LINDA-80" SH.P.K eshte me destinacion depozitimin dhe shitjen me pakice te karburanteve te lengeta nafte,benzine dhe gln. Pika e karburantit, e propozuar per tu pajisur me Leje Mjedisore te Tipit B, ushtron aktivitetin ne Ishull Lezhe, Lezhe, nje nga zonat ku ka edhe nje fluks te madh makinash sepse ndodhet buze rruges.



Me koordinatat sipas sitemit ALBANIAN 1986/GK4 jane si me poshte :

X	Y
4387329.03	4624874.87
4387323.86	4624936.13
4387368.00	4624950.11
4387392.42	4624894.79

Lloji i karburantit qe tregtohet nga shoqeria eshte :

- Nafte
- Benzine
- GLN

Pika e karburantit eshte per sherbim publik ,projektuar me pompa te palevizshme .

Ne kete pike karburanti jane 3 depozita, 1 depozite benzine dhe 2 depozita nafte .karburanti i lengshem qe do ruhet ne to eshte i tipit (nafte dhe benzine). Depozita e benzines eshte me kapacitet 5000 litra , kurse depozitat me nafte e kane kapacitetin 10.000 litra .depozitat jane



projektuar nentokesore ,te pergatitura prej llamarine celiku,me kapak individuale cilindrike dhe te vendosura brenda nje konstruksioni beton arme,te mbuluara me pllake betoni,e cila eshte ellogaritur qe te mbaje peshen e automjeteve mbi vete.cdo depozite ka bakaporta nepermjet kapakut te te ciles dalin linjat e tubacioneve per hyrje- daljen e karburantit , per shkarkimin e avujve , per matjen e nivelit dhe per marrjen e kampionit.linjat e ajrosjes se depozitave dalin tufe, ne nje zone te lire dhe larg nga objektet ,sidomos zonat e rrezikshme per zjarr. Linjat jane te pajisura me flakepenguese.

Tenda e karburantit eshte e ndertuar me konstruksion te padjegshem . ngrihen me kollona metalike , te montuara mbi plinta betoni. Perbehet nga trare dhe kapriata metalike dhe eshte e veshur me panele sanduic. Ka nje lartesi mbi 5 metra nga dyshemeja dhe ishulli i platformes dhe eshte me sip 180 m2.Ka dy aparate te palevizshme dhe te montuar poshte tendes ,ne bazamentin prej betoni. Keto aparate jane te pajisura me nga 3x3 pistoleta dhe me sherbim nga te dy anet per tregtim kaburante te lengeta . Keto pompa jane te kompletuara sipas normes , dhe te fiksuara mire ne dysheme dhe te mbuluara me veshje metalike. Elektromotori dhe linjat e tyre elektrike jane te tipit te mbyllur dhe hermetike. Ne objekt ka edhe nje parkim te perkohshem per automjetet qe kryejne sherbime ne kete pike.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pershkrimi i Rajonit

RRETHI I LEZHES ne te cilin ndodhet objekti Linda 80 sh.p.k shtrihet në Shqipërinë Veri perndimore , në bregdetin e Adriatikut. Sipërfaqja 479 km². Popullsia 54.200 banorë. Ka dy qytete: Lezha, qendër e rrethit e Shëngjini dhe 58 fshatra të grupuara në 9 fshatra të bashkuara. Dendësia mesatare; 113 banorë/km². Popullsia qytetare 18,1%, popullsia fshatare 81.9%. Rritja natyrore: 2,16%, .

Relievi

Relievi i Lezhës është pjesërisht fushor, pjesërisht kodrinor-malor.

Fushat: në Veri-Lindje - fusha e Zadriinës e formuar nga aluvionet e Drinit, në Veri-Perendim fusha e Kakarriqit (e Torovicës) e vendosur midis kodrave të Shëngjinit në Perendim dhe të Kakarriqit në Lindje , fusha e Bregut të Matit në Jug, e vendosur në bregun e djathtë të malit. Këto fusha para Çlirimit kanë qenë kënetë dhe u bonifikuan në vitet e pushtetit popullor. Tokat e tyre aluviale janë pjellore dhe tani punohen tërësisht. Malet ngrihen në anën L të rrethit (Malësia e Kashnjetit dhe malësia e Lezhës me majën më të lartë Malin e Velës: 1172 m).

Kodrat kryesore: kodrat e Shëngjinit (Rrencit) dhe të Kakarriqit në Veri-Perendim.

Klima

Klima është e butë në përgjithësi, me përjashtim të pjesës Lindore malore, ku ashpërsohet. Temperatura mesatare vjetore: 15.7° (Lezhë), temperatura më e lartë absolute:42.2° në Kallmet, temperatura më e ulët absolute: —18,5° në Kallmet. Erërat karakteristike: murlani, erë Veri-Lindje dimërore e fortë, e ftohtë dhe e thatë. Reshjet janë të shumta: 1250 mm-1800 mm në vit.

Lumenjte

Lumenjtë kryesorë: Drini i vjetër i Lezhës që vjen nga Vau i Dejës me një rrjedhë të qetë nëpër Zadrimë. Në brigjet e tij janë ngritur prita dhe nuk ndodhin më përmytje si para



Çlirimit. Gjadri rrjedh nga malet e Kashnjetit e të Pukës dhe derdhet në Drin. Drejtimi me një shtrat të ri në Drin pranë Vaut të Dejës dhe ndërtimi i një argjinate në bregun e majtë të tij e shpëtuan Zadrimën nga përmytjet. Mati në rrjedhjen e poshtme të tij hapet me një shtrat të gjerë nëpër fushë dhe formon meandre para se të derdhet në det. Zalli i Dibrit derdhet në lumin Fan të Mirditës, si liqen natyror është laguna e Kënallës në buzë të Shëngjinit dhe që lidhet me kanal me detin.

Pasuritë minerale: bakër, boksit, magnezit. Tokat bujqësore: kryesisht toka livadhore aluviale, të kafenjta malore dhe të kafenjta livadhore.

Pyjet

Pyjet: shkurre mesdhetare (70%), dushqe dhe halorë. Në të kaluarën Rreth i Lezhës ka qenë shumë i prapambetur. Kishte disa mullinj për bluarjen e drithit dhe disa punishte të vogla zejtare (kovaçana, punishte opingash etj.). Në vitet e pushtetit popullor bonifikimi i fushave (tharja e kënetave të Kakarriqit, Zadrimës, Bregut të Matit) dhe çelja e tokave të reja, mekanizimi i bujqësisë dhe rritja e modernizimi i industrisë e ktheu Lezhën në një rreth të zhvilluar bujqësor-industrial. Industria jep rreth 43% të prodhimit industrial bujqësor të rrethit. Degët kryesore janë: industria ushqimore që jep 1/2 e prodhimit industrial të rrethit (fabrika mielli, për çembrionizim misri, tharje e konservim frutash dhe perimesh, vaj luledielli dhe konserva peshku). Në strukturën e industrisë së rrethit një peshë të madhe zë industria e letrës, e cila është krijuar në dhjetëvjeçarin e fundit. Janë zhvilluar gjithashtu industria e përpunimit të drurit, ajo e prodhimit të materialeve të ndërtimit etj.

Bujqësia jep 57% të prodhimit të përgjithshëm industrial-bujqësor të rrethit. Sipërfaqja e punueshme zë 37% të sipërfaqes së rrethit. Ujitet rreth 7/10 e sipërfaqes së punueshme, 90% e zënë bimët e arave. Kulturat kryesore: gruri 30% të sipërfaqes së punueshme, misri 14.6%, luledielli, duhani, patatet, fasulet, perimet, pemët, rrushi, ullinjët. Ka 6 kooperativa të bashkuara. Rendimentet e prodhimit: gruri 34.6 kv/ha, misri 51.4 kv/ha, luledielli 15.7 kv/ha.

Në blegtori Rrethi i Lezhës dallohet në Republikë për rritjen e derrit, shpendëve e bletët. Rrugët kryesore automobilistike dhe hekurudhore: Lezhë-Shkodër, Lezhë-Tiranë. Rrethi i Lezhës ka 6 shkolla të mesme me shkëputje nga puna, 7 shkolla të mesme pa shkëputje nga puna, 26 shkolla 8-vjeçare, 47 çerdhe, 57 kopshte, 39 muze, 11 shtëpi kulture, 33 vatra kulture, ansambël folkloristik, 2 spitale, 2 poliklinika, 20 reparte lindjeje, 56 ambulanca, qendër sanitare dhe epidemiologjike, 2 shtëpi pushimi (Shëngjin). Qendra turistike: Lezha, Hoteli i Gjuetisë i Ishullit të Lezhës, rezervati i gjuetisë në Kune etj. Rrethi i Lezhës ka rrjet të gjerë të shërbimit tregtar e komunal.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni të kryer.

NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS

Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)



Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shkarkime ne uje

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nentokesore apo ne ujrat sipërfaqesore. Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi shkarkime me karakter ndotes. Shkarkimet e vetme do te jene ato te ujerave higjeno-sanitare ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Emetimet ne ajer

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk do te kete. Kryesisht do te kemi emetime nga mjetet transportit ne norma te vogla sepse jane ne kushte shume te mira teknike.

Zhurmat dhe vibrimet

Gjate zhvillimit te aktiviteti nuk krijon vibracione. Edhe ne rastin e levizjes se mjeteve te transportit nuk do te kete gjenerim te vibracioneve per shkak se nuk do te kete mjete te tonazhit te rende qe do te levizin.

Ndikimet ne flore dhe ne faune

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte. Nga ana e subjektit eshte bere e mundur mbjellja e territorit mbrapa subjektit me peme.

Ndikimet nga zjarri

Jane marre masat per te parandaluar zjarret e mundshme qe mund te ndodhin por pika e karburantit eshte pajisur me fikse zjarri, gjithashtu objekti ka nje pus me uje qe mbush depot e ujit nga depozita do shperndahet ne rrjete nentokesore.

Mbetjet e prodhuara

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te te kete gjenerim te mbetjeve. Mbetjet e pakta te prodhuara do te jene ato urbane te cilat do te grumbullohen ne kosha te posacem ku me pas do te dergohen ne vendgrumbullimin e percaktuar nga Nj.Q.V

4.MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Trajnim te punonjesve dhe masa te pergjithshme te mbrojtjes se mjedisit.



- Kontroll I shpeshte I depozitave qe mbajne lenden , per rrjedhejen apo demtimin e tyre
- Te sigurohet qe rrjeti elektrik te mos kete kontakt me mjedisin e punes
- Sigurimi I mbrotjes nga zjarri , pajisja me mjetet perkatese , fikse zjarri , uje etj
- Sigurimi qe mbetjet te trajtohen sipas planit te parashikuar.
- Sistemimi I materialeve ne vendet e caktuara.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te teknologjise dhe mjeteve te transportit
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te teknologjise qe perdoret per proceset e aktivitetit.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet /gropat kulluse ku behet shkarkimi i mbetjeve te lengeta dhe uji.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.
- Evadimi i mbetjeve te gjeneruara nga aktiviteti i punonjesve ashtu sic e parashikon legjislacioni aktual ne fuqi.
- Kontrolli periodik i konteniereve te depozitimit te mbetjeve urbane.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Jane punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Jane punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit pajisen me mjete mbrojtese si dhe uniformat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

5.Konkluzione dhe Rekomandime



- Zbatohen rregullat e sigurimit teknik në punë. Punohet për krijimin e kushteve optimale të punës per punonjesit .
- Mbetjete e lengeta / rrjedhjet qe vijne si rezultat i procesit te punes shkarkohen ne vendin e caktuar pa shkaktuar ndotje te mjedisit
- Depozitat qe mbajne lendet si nafte , benzine dhe gln jane te pajisura me flakepenguese.
- Subjekti kujdeset per menaxhimin e mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e personelit te punes, duke i transportuar ne menyte te rregullt ne vend grumbullimet e caktuara nga pushteti vendor.

Rekomandime

- Te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne mneyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari teknike te mjeteve.
- Sherbimi i automjeteve, ruajtjes se lubrifikanteve dhe pjeseve te automjeteve te behen ne vend ete tilla qe te evitojne ndotjen ne mjedis.
- Punonjesit te njihen ne mneyre periodike me kushtet e Lejes Mjedisore dhe pasojat e moszbatimit te tyre ne mjedis.
- Te pastrohen dhe mirembahen ne vijueshmeri, kanalet e drenazhim/kullimit te ujrave siperfaqesore.